



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 26 dt.14.02.1996

MBI
CELJE FONDI PER STUDIM SHESHE NDERTIMI DHE PROJEKTIM

Pasi lexuam relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbi çeljen e fondeve për studim sheshe ndërtimi dhe projektim, në bazë të ligjit Nr.7072, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” dhe të vendimit të K.M. Nr.158, dt.11.04.1994 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të pushtetit lokal”, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Nga të ardhurat e Bashkisë të çelet fondi për studim për sheshe ndërtimi dhe projektim në shumën prej 1.263.800 lekë, për objektet e mëposhtëme :

1.Adaptimi i godinës së uzinës Mekanike në rrugën e “Kavajës” 635.195 lekë

2.Adaptim banese i zyrave të Uzinës Dajti 137.181 lekë

3.Hartim i projektit të godinës 3-katëshe NTPN shtesë anësore 273.424 lekë

**4.Hartim i projektit të shtesës anësore të NTPN 5
katëshe e vlera paraprake 195.000 lekë**

**5.Studim urbanistik pjesor pranë NPV Nr.1 vlera
paraprake 23.000 lekë**

SHUMA : 1.263.800 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës Financiare e Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashki.

KRYETARI

BESNIK PETRELA